

REPUBLIC OF KOSOVO	
DPK/DMP 01	03-3789/12 23.10.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 24123/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me Gjyqtarë **Murat Paçaradën** dhe sekretarin juridik **Naim Thaqi**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës **Nora Qekezi**, nga Prishtina, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5 dhe 6 paragrafët 1 dhe 2, nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 e sanksionuar me nenin 17 paragrafi 1.1, të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtave të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Përsone Zyrat, me nr.04/L-050 në bazë të nenit, 73,74, 195,199 si dhe nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën 12.10.2012, merr këtë:

A K T V E N D I M

E pandehura **Nora Besalet Qekezi** e lindur me 09.08.1978 në Mitrovicë, tani jeton në Prishtinë Bregu i Diellit, kompleksi "Dafina" Bll.2/2 kati I 6 nr.34, me profesion ekonomiste, fakultetin e kryer, U.D.së Menaxherit për buxhet dhe financa në Prokurorin e Shtetit të Kosovës, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E

Sepse si U.D.së Menaxherës për buxhet dhe financa në Prokurorin e Shtetit të Kosovës, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë pranë Agjencionit kundër Korrupsionit në afatin e paraparë ligjor, për vitin 2011, edhe pse ka qenë e njohtuar me kohë për këtë obligim ligjor, është vonuar deri më datën 20.04.2012, kur edhe e ka bërë deklarinimin e pasurisë.

Me vprim të këtill e pandehura ka kryer kundërvajtjen nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1 dhe 2, nenit 8 paragrafi 1.2, të sanksionuar me nenin 17. Paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë, dhe Dhuratave të Zyrtave të Lartë Publik me nr.04/L-050, andaj për këtë i shqiptohet:

Q O R T I M

Spenzime e paushallit gjyqësor konform nenit 109.6 caktohen në shumën prej 15 eurosh, të cilat e pandehura është e obliguar që ti paguaj në arkën e gjykatës në afatin prej 15 ditësh.

Me nga një kopje të Aktvendimit të njoftohen e pandehura dhe parashtruesi i kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kundër Korrupsionit, me kërkesën nr.01-2162/12 të parashtruar gjykatës me datën 27.06.2012, ka propozuar që kundër të pandehurës, të zhvillohet procedura kundërvajtëse, të shpallët përgjegjëse dhe të denohet në bazë të Ligjit, për shkak të kundërvajtjes së përshkruar si në dispozitiv.

Sipas kërkesës së parashtruar është zhvilluar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës **Nora Qekezi**, e cila në mbrojtjen e vet të dhënë para kësaj Gjykate, deklaron se jam vonuar në deklarinimin e pasurisë diku për 20 ditë, edhe pse kam qenë e njohtuar me kohë por kam harrue sepse jam shumë e ngarkuar me punë.

Pas shqyrtimit të provave gjatë procedurës, shqimit të të dhënave në kërkesë dhe deklaratës së të pandehurës, gjyqtari ka fituar bindjen e lirë se i pandehura është përgjegjëse për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv.

Me rastin e marrjes së vendimit gjyqtari vlersoj të gjitha rethanet nga neni 7 i LMK-së, nën të cilat është krye kundërvajtja, ku si rrethana lehtësuese gjyqtari mori faktin se e pandehura e pranon se është vonuar, se koha e vonësës nuk është shumë e gjatë, dhe kjo harresë nuk ka qenë e qellimshme por për shkak të ngarkesave në punë, andaj gjyqtari i shqiptoi Qortim duke u bazuar në nenin 10 të LMK-së si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 109.6 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
 Nr.regj:24123/12, datë 12.10.2012



Kundër këtij aktvendimi të drejtë ankese kanë e pandehura dhe parashtruesi i kërkesës, Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate, pa taksa gjyqsore.